



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CN.nr.14/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Franciska Zhitia Ymeri, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a., me seli në Prishtinë, Divizioni i Furnizimit - Distrikti Mitrovicë, kundër debitorit M. U., IL. P., rr. “D. e K.” – V., me objekt kontesti pagesë e borxhit në vlerë 2.480.80 €, si objekt i përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm - faturës, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.02.2025, merr këtë:

### A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

### A r s y e t i m

Ish Gjykata Komunale në Vushtrri tani Degë e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a., me seli në Prishtinë, Divizioni i Furnizimit - Distrikti Mitrovicë, të datës 06.11.2008, me aktvendimin E.nr.921/08 të datës 10.11.2008, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit M. U., IL. P., rr. “D. e K.” – V., për ekzekutimin e borxhit në lartësi prej 2.480.80 €.

Ish Gjykata Komunale në Vushtrri më datë 27.04.2009 ka ftuar kreditorin që të njoftoj gjykatën për adresën e saktë të debitorit, e meqenëse kreditori nuk ka plotësuar adresën, kjo gjykatë me aktvendimin E.nr.921/08, të datës 15.06.2010 ka konsideruar si të tërhequr propozimin për përmbarim të kreditorit. Ndaj këtij aktvendimi kreditori ka paraqitë ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin Ac.nr.1096/2012 të datës 04.04.2013, ka pranuar ankesën e kreditorit, ka prishur aktvendimin e Ish Gjykatës Komunale në Vushtrri, E.nr.921/08, të datës 15.06.2010 dhe çështjen ia ka kthyer Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri në rivendosje.

Më pas, Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, me aktvendimin CP.nr.10/14, të datës 13.12.2023, në pikën I të dispozitivit është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike përmbarimore, të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a., me seli në Prishtinë, Divizioni i Furnizimit - Distrikti Mitrovicë, me seli në Prishtinë, Bulevardi “Nënë Tereza”, nr. 36, kundër debitorit M. U. - IL P., me seli në V., rr. “D. e K.”, ndërsa në pikën II të dispozitivit është vendosur që pasi që ky aktvendim të merr formë të prerë, lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë - Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.649/2024, të datës 13.12.2024, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të hapë konflikt kompetence në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega Vushtrri, për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a., me seli në Prishtinë, Divizioni i Furnizimit - Distrikti Mitrovicë dhe debitorit M. U., IL. P., Rr. “D. e K.” -V. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-së dhe nenin 13 pika 7, të Ligjit Nr.08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a., me seli në Prishtinë, Divizioni i Furnizimit - Distrikti Mitrovicë, më datë 06.11.2008, ka parashtruar propozim për përmbarim në Ish Gjykatën Komunale në Vushtrri, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori M. U., IL. P., rr. “D. e K.” – V., që t’ia paguaj shumën prej 2.480.80 €. Gjykata ka lejuar propozimin për përmbarim të paraqitur nga kreditori, ndërsa me aktvendimin CP.nr.10/14, të datës 13.12.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës për vendosje të mëtejme.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë çështje juridike me kompetencë lëndore për të vendosur është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, për këto arsye:

Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbarues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe.”* Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, parashihet që: *“Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”.* Me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhoma e Shkallës së Parë dhe Dhoma e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive*

*tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, dhe 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”.*

Mbi këtë bazë, rezulton se kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përbarimore është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, për faktin se palët në këtë çështje përbarimore kur është paraqitur propozimi për përbarim dhe lënda ka qenë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, nuk kanë ushtruar ndonjë mjet juridik kundër vendimit për përbarim, ndërsa kreditori nuk ka kërkuar që lënda të kaloj te përbaruesi privat ashtu siç është përcaktuar me nenin 397 të LPP-së. Si rezultat i kësaj, Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, mbi bazën e këtyre rrethanave, nuk ka mundur të shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, por është dashur të vazhdoj në trajtimin e rastit.

Nëse ndonjëra nga palët do të paraqiste ndonjë mjet juridik në këtë çështje përbarimore, ndërsa çështja është në kompetencë të Gjykatës Komerciale, kjo gjykatë do të kishte kompetencë lëndore që të vendosë për të gjitha mjetet juridike, ashtu siç është përcaktuar me LPP dhe nenin 13 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkesave të lëndës e bazuar në dispozitat e lartcekura, gjeti se gjykatë me kompetencë lëndore për të vendosur sipas propozimit për përbarim është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**

CN.nr.14/2025, datë 24.02.2025

Kryetari i kolegjit - gjyqtari  
Lumni Sallauka